



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-133/1

Në bazë të nenit 14.10 dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr.05/L-080), Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi i Bordit duke ushtruar kompetencat e tyre emergjente konform nenit 11 të Statutit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, me datën 16 mars 2020, marrin vendimin e mëposhtëm emergjent.

Ky vendim emergjent merret duke pasur parasysh natyrën e urgjencës objektive për të cilën nuk ka qenë e mundur të vendoset në një mbledhje të zakonshme të Bordit, apo duke shfrytëzuar procedurën e vendosjes sipas nenit 9.5 të Statutit të Bordit, dhe ky vendim i nënshtrohet ratifikimit të Bordit në takimin e radhës.

Ky vendim propozohet duke u bazuar në vendimin e Qeverisë së Kosovës së datës 15.03.2020, nr. 01/21 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik për shkak të gjendjes së krijuar për shkak të shpalljes së pandemisë nga OBSH për shkak të Coronavirus/Covid19 dhe për shkak të rasteve të shfaqura në Republikën e Kosovës.

Prandaj, Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi duke vepruar së bashku marrin vendimin si më poshtë:

**VENDOSJET QE:**

- i) Pezullohen të gjitha procedurat e likuidimit lidhur me vendimet e Bordit të Drejtorëve nr. Ref. BD-129/56 të 29 janar 2020 për tetë (8) NSH/asete dhe vendimit nr. Ref. BD 130/01 të AKP-së të datës 21 shkurt 2020 për njëzet e tetë (28) NSH/asete;
- ii) Shtyhet vendosja në likuidim për një afat të pacaktuar kohor për 36 NSH/Asetet sipas paragrafit I të këtij vendimi sipas listës së bashkangjitur në Shtojcën I të këtij vendimi;
- iii) Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kopja e këtij vendimi i dërgohet anëtarëve të Bordit menjëherë pas nënshkrimit.

Bashkangjitur me këtë vendim është memorandum i paraqitur nga Menaxhmenti i Agjencisë në bazë të të cilave informata dhe rekomandime është marrë vendimi dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Prishtinë, 21 /04/2020

Bajram Zejnullahu

Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Skender Komoni

Zëvendës Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Shtojca I :

Nr.	ID e NSh-së	Emri i NSh-së	Komuna
1	MIT106	Fabrika e Tullave dhe Tjegullave	Zveçan
2	MIT107	Ndermarrja Ndertimore Industriale Berilje	Mitrovica e Veriut
3	MIT126	Shoqata e Kooperativave Bujqesore	Zveçan
4	MIT151	Kras Zagreb	Mitrovica e Veriut
5	MIT152	Bagat Beograd	Mitrovica e Veriut
6	MIT153	Ibar Invest Zubin Potok	Zubin Potok
7	MIT156	Planika Kranj	Mitrovica e Veriut
8	MIT157	7 Juli	Mitrovica e Veriut
9	MIT162	Ibar	Mitrovica e Veriut
10	MIT164	Ndermarrja Ndertimore Ndertimtari	Glllogoc
11	PEJ166	Pushimorja e Femive	Deçan
12	PRN170	JUGOPETROL	Prishtinë
13	PRN180	DUNAV OSIGURANJE	Prishtinë
14	PRN183	KOMPANIA E SIGURIMEVE KOSOVA	Prishtinë
15	PRN184	MONTING ENERGETIKA	Prishtinë
16	PRN185	ORGANIZATA E PËRBËRË RILINDJA	Prishtinë
17	PRN186	EMINENT	Prishtinë
18	PRN190	Centrotexil-Import-Export	Prishtinë
19	PRN191	NISPROMET	Prishtinë
20	PRZ079	Varteks Varazhdin	Prizren
21	PRZ086	KB Bujku Drenovc Rahovec	Rahovec
22	PRZ087	KB Zocishta Zoqishtë Rahovec	Rahovec

BZ

S.V

Nr.	ID e NSh-së	Emri i NSh-së	Komuna
23	PRZ090	KB Hoqa e Qytetit	Prizren
24	PRZ091	KB Optrusha	Rahovec
25	PRZ092	KB Krusha e Madhe	Rahovec
26	PRZ093	KB Mamusha	Mamushë
27	PRZ094	KB Studencani	Suharekë
28	PRZ007	Sharrprodhimi	Dragash
29	MIT056	Vijak/Gradec	Zubin Potok
30	MIT119	Ndermarrja per menaxhimin e banesave	Mitrovica e Jugut
31	MIT165	Iskra	Mitrovica e Veriut
32	PEJ205	Agrohemizacia	Pejë
33	PRN192	KB Slloga	Prishtinë
34	PRN194	Solid	Prishtinë
35	PRN195	Vojvodanska Banka a.d.	Prishtinë
36	PRN196	OTHPB Transped Kontinentalna Shpedicija - Beograd	Prishtinë

B7

S. V



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-133/2

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe nenit 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30 Prill 2020 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Procesverbalet e mbledhjeve urgjente të Bordit së Drejtorëve të mbajtura më me 23 Mars 2020 dhe 27 Mars 2020 të paraqitura për miratim, nëpërmjet kësaj miratohen si procesverbale të mbledhjeve të Bordit të cekura më lartë.**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

Prishtinë, më 30/04/2020



Bajram Zejnullahu

Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Vendimi me numër të referencës: **BD/133-3**

**Vërejtje:**

Ky Vendim nuk është publikuar për shkak se ka të bëjë me çështje të brendshme, qoftë organizative apo procedurale të Agjencisë dhe përmban informacione të individëve të caktuar që mund të bie ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji 03/L-172).

Agjencia ju njofton se në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (L-03/L-215), palët e interesuara mund të parashirojnë kërkesë specifike me arsyetim përkatës për qasje në këto Vendime tek Zyrtari përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-133/4

Në bazë të nenet 5, 9, 14.10 dhe 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), dhe neneve 2.1.6, 6, 7, 12, 16, 35 dhe 49.1 të Shtojcës së po të njëjtit Ligj, si dhe nenit 11 të Statutit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, duke iu referuar vendimit emergjent Nr. Ref. BD.133/1 për pezullimin e procedurave të likuidimit për 36 NSH/asete, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen urgjente të mbajtur me datën 30 Prill 2020 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me këtë refuzon ta konfirmojë, dhe ta njohë si të vetin, vendimin Nr. Ref. BD-133-1 të datës 21 Prill 2020 të nënshkruar nga Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi i Bordit;
- II. Lidhur me vendimet e Bordit të Drejtorëve nr. Ref. BD-129/56 të 29 janar 2020 për tetë (8) NSH/asete dhe vendimit nr. Ref. BD 130/01 të AKP-së të datës 21 shkurt 2020 për njëzet e tetë (28) NSH/asete, caktohet një afat i ri shtesë 45 (katërdhjetë e pesë) ditor për dorëzimin e kërkesave kreditore për 36 NSH/Asetet sipas listës së bashkangjitur në Shtojcën I të këtij vendimi;
- III. Udhëzohet Menaxhmenti i Agjencisë që njoftimin publik për afatin e ri shtesë ta shpallë në faqen e internetit të AKP-së kur vlerësohet se masat kufizuese të lëvizjes së qytetarëve të vendosura nga Qeveria e Republikës së Kosovës nuk pamundësojnë dorëzimin e rregullt të kërkesave kreditore nga parashtruesit potencial.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 30/04/2020



Bajram Zejnullahu

Kryesues

Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimi



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-133/5

Në bazë të nenit 15.1 dhe 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin Nr.05/L-080), dhe sipas propozimit të Menaxhmentit të Agjencisë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 30 Prill 2020 nxjerr këtë:

## V E N D I M

I. Aprovohet kërkesa e Menaxhmentit të Ndërmarrjes së Re “MIM Golesh” për huazimin e mjeteve nga Tarifa Administrative e AKP-se.

II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 30/04/2020



Bajram Zejnullahu

Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-133/6

Në bazë të neneve 2.7, 15.2.7 dhe 19A të Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 30 Prill 2019 nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Menaxhmentit të AKP-së që mjetet monetare të identifikuar si Fonde të Përkohshme sipas nenit 2.7 të Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-80 dhe Ligjin nr. 04/L-115 nga 134 NSh-të/Asetet e paraqitura në listën e bashkangjitur si shtojca 1, në shumën totale prej EUR 55,015,325.68 të barten në llogarinë 1000400070007358 "AKP Fondet e Përkohshme" e hapur nga Ministria e Financave në Bankën Qendrore të Kosovës; dhe
- II. Udhëzohet Kryesuesi i Bordit të AKP-së që të njoftoj Kryetaren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kryeministrin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrinë e Financave me Vendimin e aprovuar dhe njëkohësisht t'i informoj se sipas nenit 2.7 dhe 19A të Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-80 dhe Ligjin nr. 04/L-115, "...në rast se fondi në mirëbesim i Ndërmarrjes Shoqërore përkatëse, pas transferimit të fondeve të përkohshme në Fondin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës, është i pamjaftueshëm për përmbushjen e të gjitha kërkesave kreditore të cilat përfundimisht vendosen si të vlefshme pas procesit të ankesave në Dhomën e Posaçme apo për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve tjera të Agjencisë sipas Ligjit bazik, Agjencia e njofton Qeverinë për këtë. Qeveria brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike, ia kthen Agjencisë shumën e nevojshme nga fondet e përkohshme, të cilat Agjencia i përdorë për përmbushjen e kërkesave kreditore në procesin e likuidimit dhe mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve tjera të Agjencisë, që ndërlidhen me Ndërmarrjen Shoqërore përkatëse".
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 30/04/2020



Bajram Zejnullahu

Kryesues

Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-133/7


Në bazë të Nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me 30 Prill 2020, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. Shtyhen afatet për dorëzimin, pranimin dhe shqyrtimin e ankesave të punëtorëve, për ndërmarrjet Bistrica në Drenovc Pejë, NSH Lidhja e Vozitësve Prizren, NSH Kabllar Prishtinë, NSH Teuta Bare Mitrovicë, NSH Kosovatrans Gjilan dhe NSH Integj Gjilan për afat të pacaktuar.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve

Prishtinë, më 30/04/2020



Bajram Zejnullahu  
  
Kryesues  
Bordi i Drejtorëve  
Agjencia Kosovare e Privatizimit